

V E N D I M
Nr.284, datë 5.6.1995

PËR KRIJIMIN E PARQEVE INDUSTRIALE

Me qëllim që të nxiten investimet e huaja dhe të krijohen kushte sa më të përshtatshme për zhvillimin e biznesit e sidomos të prodhimeve industriale, me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të krijohen parqet industriale në rrethe të ndryshme të vendit, mbi bazën e studimeve përkatëse.
2. Veprimtaria e parkut industrial të synojë kryesisht prodhime industriale me përparësi eksportin, si veshje, përpunim lëkure, përpunim druri, mallra sportive, montime elektronike, prodhime plastike, lodra etj., si dhe shërbime të ndryshme.
3. Parku industrial të vendoset në zona jashtë qytetit me sipërfaqe nga 20-50 ha.
4. Për studimin, organizimin dhe hartimin e dispozitave të nevojshme ligjore për parqet industriale ngrihet grupi i punës me përfaqësues nga Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Ministria e Financave, Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Agjencia për Nxitjen e Investimeve të Huaja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
5. Puna për krijimin e parkut industrial në rrethin e Durrësit të jetë detyrë parësore e grupit të punës.
6. Ngarkohet Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë për zbatimin e këtij vendimi, si dhe për hartimin e rregullores përkatëse për mënyrën e organizimit e të administrimit të parqeve industriale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi